



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:116816
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05763022

E.nr.76/11

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega në Shtërpcë, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B.E. sh.a, me seli në Prishtinë, rr "...", të cilën e përfaqëson Kompania e Avokatëve "Arbresh", me seli në Prishtinë, rr "Brigada 153", R.D., H., kundër debitorëve N.P.SH "E. – G.", me seli në fsh ..., Komuna e Shtërpcës, me pronar Z.A. dhe M.K. nga fsh ..., Komuna e Shtërpcës, për pagesën e borxhit, me datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën E.nr.76/11, për shkak të tërheqjes së propozimit për përmbarim nga kreditori.

A r s y e t i m i

Kreditori Banka Ekonomike sh.a, më datë 23.12.2011, në këtë gjykatë, ka ushtruar propozim për përmbarim, sipas dokumentit përmbarimor, kontratës së pengut nr.322/Fe, të datës 07.09.2009, për pagesën e borxhit, kundër debitorëve N.P.SH "E.– G." dhe M.K..

Me datë 31.05.2024, i autorizuari i kreditorit, me parashtrësë me shkrim, pas pranimit të konkluzionit të datës 21.05.2024, të dërguar nga gjykata, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq në tërësi propozimin për përmbarim ndaj debitorëve.

Meqenëse i autorizuari i kreditorit e ka tërhequr në tërësi propozimin për përmbarim të ushtruar kundër debitorëve, Gjykata vendosi që procedurën përmbarimore ta përfundoj në pajtim me nenin 42, par 2, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.76/11, më datë 21.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi